



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KZAZ NR. 10, DY ANËTARËVE TË KZAZ NR. 43, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 10, dy anëtarëve të KZAZ nr. 43, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5; neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 114, datë 02.04.2019, ka emëruar anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, kërkon:

- lirim dhe emërim të anëtares të KZAZ nr.10, Qarku Kukës (shkresa nr. 3983 prot., datë 20.05.2019);
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.43, Qarku Tiranë (shkresa nr. 3991 prot., datë 20.05.2019).

Nr. 606 i Vendimit Data 21.05.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 10, dy anëtarëve të KZAZ nr. 43, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Kërkesa dhe propozimet e paraqitura nga Partia Socialiste e Shqipërisë, janë në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 3971 prot., datë 19.05.2019, anëtari i emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 43, z. Andi Proshka, ka paraqitur dorëheqjen nga detyra për arsye objektive.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, rezultojnë të pa emëruar 232 shtetas, por asnjë prej tyre nuk është me vendbanim në Bashkinë Rrogozhinë.

Shtetasit e listës së miratuar me vendim të KQZ-së, të pa emëruar kryesisht nga KQZ, nuk përmbushin kriterin e vendbanimit në zonën zgjedhore ku është krijuar vakanca, Bashkia Rrogozhinë.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 141, datë 09.04.2019, rezulton se plotëson kriteret e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për plotësim të vakancës në KZZ nr. 43, z. Ermal Sula.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ-së nr.10, dy anëtarë të KZAZ-së nr.43, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë anëtarin e KZAZ-së nr.10, dy anëtarë të KZAZ-së nr.43, sipas lidhjes nr.2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Nr. 606 i Vendimit Data 21.05.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 10, dy anëtarëve të KZAZ nr. 43, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

